

Efikasiteti Energjetik Industrial

Platforma e shpërndarjes së informatave mbi praktikat më të mira



MBI PROJEKTIN

Projekti "Nxitja e transformimit të tregut për efikasitetin energjetik në industri dhe përsheptimi i investimeve në praktikat dhe teknologjitë më të mira" ka për qëllim t'i zvogëlojë emisionet e gazrave serë nga industria në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke përsheptuar transformimin e tregut maqedonas për Efikasitetin Energjetik Industrial (EEI). I realizon këto qëllime duke zgjeruar ofertën e shërbimeve konsultante dhe investimeve dhe duke identifikuar dhe nxitur përdorimin e praktikave dhe teknologjive më të mira për EEI-në, siç janë sistemet e menaxhimit të efikasitetit energjetik dhe sistemet e optimizimit të energjisë.

Projekti i mbështet qëllimet e zvogëlimit të emisioneve të gazrave serë nga industria dhe transformimin e tregut lokal për efikasitetin energjetik në industri përmes ndërhyrjeve për t'i hequr pengesat në tri nivele.

Qëllimi i platformës për shpërndarjen e informatave dhe praktikave më të mira të EEI-së është të rrisë ndërgjegjësimin dhe t'i zgjerojë njohuritë e vendimmarrësve në industri dhe institucioneve në lidhje me mundësitë, përfitimet dhe shpenzimet që lidhen me EEI-në. Qëllimi i platformës është të sigurojë informata dhe mjete që do të përdoren kryesisht nga konsulentët e efikasitetit energjetik dhe personali i ndërmarrjeve industriale.

KOMPONENTËT E PROJEKTIT

Komponenti i projektit 1

Qëllimet drejt certifikimit të personalit të menaxhimit të energjisë në konsumatorët e mëdhenj të energjisë; stimulimet për t'i zbatuar sistemet e menaxhimit të energjisë dhe shpërndarja e informatave mbi praktikat më të mira të EEI-së. Promovon përdorimin e mjetit të menaxhimit të të dhënave për energjinë industriale; vlerësimi i teknologjive klimatike në industri dhe forcimi i ekspertizës institucionale të EEI-së.

Komponenti i projektit 2

Zbaton trajnime për konsulentët e EEI-së në përputhje me standardin ISO 50001; Optimizimi i Sistemit të Avullit (OSA); dhe Optimizimi i Sistemeve të Ajrit të Kompresuar në Industri (OSAK).

Komponenti i projektit 3

Ofron ndihmë teknike për përgatitjen dhe vlerësimin e propozimeve të projektit për investim në EEI.





IDEJA PAS EEI PSHIPM

Programi EEI PSHIPM ofron pikë fillestare për personat që janë përgjegjës për menaxhimin e energjisë dhe efikasitetin energjetik industrial dhe për punonjësit e ndërmarrjeve industriale që kërkojnë informata dhe resurse për promovimin, përpunimin dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit të energjisë dhe teknikave dhe masave të tjera të dëshmuara të EEI-së.

Qëllimet e Platformës EEI PSHIPM janë:

- 1) Ndërtimi / forcimi i argumenteve afariste në favor të zbatimit të sistemit të menaxhimit të energjisë; projektet e Optimizimit të Sistemeve të Avullit (OSA); dhe për Optimizimin e Sistemeve të Ajrit të Kompresuar në Industri (OSAK); dhe teknikat dhe teknologjitë e tjera të dëshmuara për EEI-në;
- 2) Identifikimi dhe përgatitja e masave të kursimit të energjisë dhe projekteve të përmirësimit të EEI-së;
- 3) Mbështetja për mësimin e pavarur dhe zhvillimin e aftësi;
- 4) Lidhja e firmave me konsulentët e sistemeve të menaxhimit të energjisë dhe ofruesit e shërbimeve;

Platforma EEI PSHIPM është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Agjencisë së Energjetikës të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qendrës Rajonale të Mjedisit Jetësor, në bashkëpunim me Organizatën e Zhvillimit të Industrisë të Kombeve të Bashkuara, UNIDO dhe Fondin Ekologjik Global GEF.

Platforma përqendrohet në 2 elemente - sistemet e menaxhimit të energjisë në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e standardit ISO 5001 dhe optimizimi i sistemeve të energjisë për kursimin e energjisë dhe mjeteve në para, të shoqëruar me zvogëlimin e gazrave serë.

Projekti financohet nga Fondi Global i Mjedisit Jetësor me kontribut nga UNIDO, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës, Banka Maqedonase për Mbështetjen e Zhvillimit, Projekti i USAID-it për Menaxhimin e Energjisë (IEM), Fakulteti i Teknologjisë dhe Metalurgjisë në Universitetin Shën Cirili dhe Metodi dhe shumë ndërmarrje të sektorit privat. Është zbatuar nga UNIDO dhe është realizuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit Jetësor Zyra në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

EEI PSHIPM dëshiron të ofrojë platformë për ndërgjegjësimin në industri dhe publikut në lidhje me praktikat më të mira të Maqedonisë dhe rrëfimet e suksesshme në zbatimin e sistemit të menaxhimit të energjisë dhe efikasitetin energjetik në industri.



Agjencia e Energjetikës e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Jurij Gagarin 15
1000 Shkup
ea@ea.gov.mk



Qendra Rajonale e
Mjedisit Jetësor
Bukureshka 133b, 1000 Shkup
CO.Macedonia@rec.org